



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:188965
Datë: 07.10.2024
Numri i dokumentit: 06262925

C.nr.3725/17

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Argzon Muçaj, në çështjen juridike kontestimore të paditësit N.B. nga Prishtina, i përfaqësuar nga T.Zh. avokate nga Prishtina, kundër të paditurve F.B. dhe F.B. nga Prishtina, në çështjen juridike të kompensimit të dëmit, në shqyrtimin kryesor publik të mbajtur me datë 23.09.2024 në prani të përfaqësuesit të autorizuar të paditësit, e në mungesë të të paditurve të ftuar me rregull, ndërsa me datë 07.10.2024, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I. Aprovohet pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditësit N.B. nga Prishtina.

II. DETYROHEN të paditurit F.B. dhe F.B. nga Prishtina, në emër të kompensimit të dëmit jo material dhe material të shkaktuar me datë 28.05.2015, paditësit në mënyrë solidare t'ia paguajë shumat si në vijim:

1. në emër të dëmit jo material

- a) për dhimbje të përjetuara fizike shumë prej800.00 euro
b) për frikën e përjetuar shumë prej.....700.00 euro

2. në emër të dëmit material

- a) në emër të ndihmës dhe kujdesit nga personi i tretë shumë prej..... 20.00 euro
b) në emër të ushqimit të përforcuar shumë prej..... 150.00 euro

III. DETYROHEN të paditurit që paditësit, shumat e gjykuara si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, t'ia paguajë me kamatë ligjore prej 8% në vit, për dëmin jo material do të rrjedh nga dita e nxjerrjes së aktgjykimit me datë 07.10.2024, kurse për dëmin material nga dita e parashtrimit të padisë 29.12.2017, e deri në pagesën e tërësishme, si dhe shpenzimet e procedurës në lartësi prej 849.60 euro, e të gjitha në afat prej 15 ditëve nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi, nën kërcenim të përbarimit ligjor.

IV. REFUZOHET E PABAZUAR pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit, përtej shumave të gjykuara në pikën II të dispozitivit, për kompensimin e dëmit jo material në emër të dhimbjeve fizike nga shuma e gjykuar 800.00 euro e deri në shumën e kërkuar në lartësi prej 2,000.00 euro dhe në emër të frikës së përjetuar nga shuma e gjykuar 700.00 euro e deri në shumën e kërkuar në lartësi prej 2,000.00 euro, dhe për dëmin material në emër të ndihmës dhe kujdesit nga personi i tretë nga shuma e gjykuar prej 20.00 euro e deri në shumën e kërkuar në lartësi prej 300.00 dhe në emër të ushqimit të përforcuar nga shuma e gjykuar 150.00 euro e deri në shumën e kërkuar në lartësi prej 200.00 euro.

A r s y e t i m

Paditësi N.B. nga Prishtina, i përfaqësuar sipas autorizimit nga T.Zh., avokate nga Prishtina, në këtë gjykatë me datë 29.12.2017 ka paraqitur padi, kundër të paditurve F.B. dhe F.B. nga Prishtina, me kërkesë kompensimin e dëmit material dhe jo material.

Paditësi përmes padisë, në seancën e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se me datë 28.05.2015 pas një mosmarrëveshje në mes të paditësit dhe të paditurve në vendin e quajtur “t. sh.”, për deri sa paditësi ka qenë duke punuar taksit, për një moment të paditurit kanë filluar të godasin paditësin me grushte dhe me mjete të forta, duke i shkaktuar lëndime në pjesë të ndryshme të trupit. Ka shtuar se, të paditurit janë dënuar në procedurë penale përmes Aktgjykimit P.nr.3105/16 i datës 18.12.2017, ndërsa paditësi për kompensimin e dëmit është udhëzuar në kontest civil. Tutje, ka qëndruar prapa precizimit të kërkesëpadisë, duke kërkuar nga gjykata që e njëjta të aprovohet dhe të detyrohen të paditurit F.B. dhe F.B. nga fshati B. Komuna e Prishtinës që paditësit në emër të kompensimit të dëmit material të shkaktuar me datë 28.05.2015, dhe atë për perkujdesje dhe ndihmë nga personi i tretë t’ia paguajnë shumën prej 300.00 euro, në emër të ushqimit të përforcuar shumën prej 200.00 euro, në emër të dëmit jo material për dhimbjet fizike shumën prej 2000.00 euro dhe për friken e shkaktuar në shumë prej 2000.00 euro, e në shumën e përgjithshme prej 4500.00 euro, me kamatë ligjore prej 8% duke llogaritur nga data e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar, dhe atë për padi 104.00 euro, për taksë gjyqësore shumën prej 40.00 euro, për përfaqësim në katër seanca në secilën nga 135.20 euro e në shumën e përgjithshme për seanca 540.80 euro dhe për ekspertiza mjekësore shumën prej 300.00 euro.

Të paditurit përmes përgjigjes në padi dhe në seancat gjyqësore, e kanë kundërshtuar në tërësi padinë dhe kërkesën e saj, duke konsideruar se e njëjta është e pa bazuar si në aspektin formal, e po ashtu edhe në atë përmbajtësor. Kanë theksuar se, padisë nuk i është bashkëngjitur asnjë provë materiale e cila do të vërtetonte se paditësi ka pësuar lëndime trupore. I padituri i parë F.B. ka deklaruar se nuk kamë qenë në vendngjarje kur ka ndodhur ky problem, e po ashtu nga gjykata penale jam liruar nga aktakuza. Ndërsa, i padituri i dytë F.B. ka deklaruar se nuk qëndrojnë pretendimet e paditësit, nuk i kemi shkaktuar lëndime trupore, ai ka ardhur në veturë dhe me ka sulmuar, është kthyer në vijat e këmbësoreve dhe ka tentuar të me sulmoj. Gjykatës i kanë propozuar që padia dhe kërkesa e saj të refuzohet si e pa bazuar.

Gjykata seancën e shqyrtimit kryesor të datës 23.09.2024 e ka mbajtur në mungesë të palëve të paditura, për faktin se të njëjtit kanë qenë të ftuar në mënyrë të rregullt përmes procesverbalit nga seanca e kaluar. Po ashtu, në këtë seancë, gjykata e ka lejuar precizimin e kërkesëpadisë pa prezencën e të paditurve, kjo për faktin se precizimi konkret nuk paraqet ndryshim të padisë, dhe atë duke u bazuar në nenin 257 paragraf 2 të LPK-së, i cili nen parasheh se padia nuk quhet e ndryshuar po që se paditësi e ka zvogëluar kërkesëpadinë. Në këtë rast, paditësi përmes precizimit e kishte zvogëluar kërkesën e tij nga vlera fillestare e padisë që ishte në shumën prej 4,800.00 euro në vlerën prej 4,500.00 euro. Andaj, bazuar në këtë, gjykata e vazhdoj seancën e shqyrtimit kryesor pa i njoftuar palët e paditura.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike lidhur me këtë çështje kontestimore, gjykata në shqyrtimin kryesor publik të mbajtur më 23.09.2024, bëri administrimin e provave të propozuara nga palët dhe atë: Raportin mjekësor të datës 28.05.2015 i lëshuar nga Qendra Klinike Universitare – Qendra Emergjente, Raportet mjekësore të lëshuara me datë 29.05.2015, 31.05.2015, 03.06.2015 dhe raporti i datës 04.06.2015, Raportin e lëshuar nga QKUK i datës 08.06.2015, Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë me numër P.nr.3105/16 i datës 18.12.2017 dhe ekspertizat mjekësore të datës 08.04.2024.

Pasi që gjykata e bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, bazuar në nenin 8 të LPK-së, arriti në përfundimin se në këtë çështje juridike civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga deklaratimet e palëve ndërgjyqëse në këtë çështje juridike kontestimore rezulton se kontestuese është baza e kërkesëpadisë, e po ashtu edhe lartësia e saj.

Nga Raporti mjekësor i datës 28.05.2015 i lëshuar nga Qendra Klinike Universitare – Qendra Emergjente në emër të paditësit, gjykata konstatoj se paditësi me këtë datë ka kërkuar shërbime mjekësore në Qendrën Emergjente, si pasojë e lëndime trupore.

Nga Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë me numër P.nr.3105/16 i datës 18.12.2017, gjykata konstatoj se i njëjti aktgjykim është i plotfuqishëm nga data 31.01.2018, dhe me të njëjtin të paditurit janë shpallur fajtor për kryerjen e veprës penale Lëndim i lehtë trupor e përcaktuar me nenin 188 paragraf 1.4 lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, për shkak se me datë 28.05.2015, rreth orës 21:00 në rrugën “Xh.B.” të pandehurit këtu në këtë procedurë të paditurit F.B. dhe F.B. për një mosmarrëveshje që kishin me të dëmtuarin këtu në këtë procedurë paditësin, për deri sa paditësi ishte duke pritur në rend për të marr udhëtarët, pasi që të njëjtit punonin si taksi, të paditurit e kanë sulmuar paditësin me çka i kanë shkaktuar lëndime të lehta trupore. Paditësi, me këtë aktgjykim, ishte udhëzuar në kontest civil për realizimin e kërkesës së tij pasurore-juridike.

Me qëllim të konstatimit të shkallës së lëndimeve trupore, e po ashtu për të vlerësuar frikën e paditësit të shkaktuar si pasojë e lëndimeve trupore, gjykata sipas propozimit të paditësit, ka nxjerr provat përmes ekspertizave mjekësore dhe atë nga eksperti mjekësor ortoped Dr. A.T. dhe ekspertja mjekësore psikiatër Dr. A.G. Ekspertët mjekësor pas shqyrtimit të dokumentacionit të

prezantuar në shkresat e lëndës, si dhe pas ekzaminimit të paditësit, kanë konstatuar se paditësi ka pësuar lëndime të natyrës së lehtë trupore.

Sipas vlerësimit të ekspertit mjekësor ortoped Dr. A.T., të dhënë përmes ekspertizës mjekësore, i njëjti në bazë të raporteve mjekësore në shkresa të lëndës dhe atë bazuar në: Raportin mjekësor nga Qendra Emergjente në Prishtinë, i datës 28.05.2015, me nr. protokollin 1866, Raportin e TK e kokës i datës 08.06.2015, Raporteve mjekësore që gjenden në shkresa të lëndës dhe nga ekzaminimi i drejtpërdrejt i paditësit, ka konstatuar se me datën 28.05.2025 paditësi ka pësuar këto lëndime trupore: ndrydhje e kokës, ndrydhje e qafës, ndrydhje e regjionit të krahut të djathtë, ndrydhje e hemitoraksit të djathtë, ndrydhje e shpatullës së djathtë, duke konstatuar se këto lëndime për nga natyra e tyre konsiderohen si lëndime të lehta trupore. Eksperti ka konstatuar se, paditësi si pasojë e këtyre lëndimeve dhembjet fizike të intensitetit të rendë kanë zgjatur 2 ditë, dhembje kohë pas kohe deri në veprimin e terapisë së ordinuar, për shkak të lëndimeve në disa pjesë të trupit, ndërsa dhembjet fizike të intensitetit të mesëm, kanë zgjatur 15 ditë, kohë e cila është e nevojshme për tërheqjen e spazmës muskulore, edemes së indeve, hematomave, nën veprimin e terapisë, kurse dhembjet fizike të intensitetit të ulët sipas ekspertit shfaqen edhe sot e kësaj dite, me dhembje të qafës sidomos gjatë sforcimeve fizike me duar, sipas të dhënave anamnestike të paditësit.

Lidhur me frikën e përjetuar, ekspertja mjekësore duke u bazuar në raportet mjekësore që gjenden në shkresat e lëndës dhe atë: Raportin mjekësor nga Qendra Emergjente në Prishtinë, i datës 28.05.2015, me nr. protokollin 1866, Raportin e TK e kokës i datës 08.06.2015, Raporteve mjekësore që gjenden në shkresa të lëndës dhe nga ekzaminimi i drejtpërdrejt i paditësit, ka konstatuar se me datën 28.05.2025, paditësi ka përjetuar: frikë primare: në momentin e rrahjes në formë të frikës intensive nga kërcënimi i integritetit të tij fizik e që ka zgjatur disa sekonda, frikë sekondare të intensitetit të lartë të manifestimit: ka pasur për 3 ditë manifestuar me gjendje të shqetësimit psikomotorik, pagjumësi, anktheve dhe tmerreve të natës me zgjime të shpeshta gjatë natës. Kjo ka kaluar në frikë sekondare të intensitetit të mesëm: dhe që ka zgjatur për 20 - 30 ditë ku është manifestuar me ëndrra rekurente shqetësuese rreth ngjarjes, sjellje apo ndjenja sikur ngjarja traumatike të ishte duke u përsëritur. Ekspertja ka konstatuar se, frika sekondare e intensitetit të ulët të manifestimit e cila ka zgjatur më shumë se 5 muaj dhe ende vazhdon pas rrahjes - përleshjes e manifestuar me ankthe dhe shqetësime të natyrës emocionale, çrregullim të gjumit me rënie të koncentrimin, humor të ulët dhe paqëndrueshmëri në relacionet sociale, kjo gjendje është shoqëruar me rikujtime të ngjarjes traumatike që ka qenë me frikë dhe pasiguri gjë që ka ndikuar edhe në funksionimin e tij social dhe profesional. Ekspertja ka konstatuar se, shëmtimi trupor nuk ekziston, e po ashtu as zvogëlimi i përhershëm i aktivitetit jetësor. Në raport me ndihmën dhe përkujdesjen nga personi i tretë, ekspertja ka konstatuar se e njëjta ka qenë e nevojshme për 2 ditë, ndihmë për të kryer disa nga aktivitetet e përditshme jetësore, i ndihmuar nga familjaret, siç janë veshmbathja, higjiena personale, përgatitja e ushqimit, etj. Kurse në raport me ushqimin e përforcuar, ka konstatuar se i njëjti ka qenë i nevojshëm për 15 ditë, dhe atë ushqim i pasur me albumina, minerale dhe vitamina, ushqim me i përforcuar se i zakonshmi, i cili ndikon në rritjen e forcave imunitare të organizmit.

Sa i përket ndihmës nga personi i tretë, eksperti ka konstatuar se e njëjta ka qenë e nevojshme në kohëzgjatje prej dy ditë, ndihmë kjo për të kryer disa nga aktivitetet e përditshme jetësore, i ndihmuar nga familjaret, siç janë veshmbathja, higjiena personale dhe përgatitja e ushqimit. Ndërsa, sipas ekspertit mjekësor, ushqimi i përforcuar ka qenë i nevojshëm për 15 ditë, ushqim i pasur me albumina, minerale dhe vitamina, i cili ndikon në rritjen e imunitetit.

I autorizuari i palës paditëse, në seancën e shqyrtimit kryesor, ka deklaruar se i ka pranuar ekspertizat mjekësore, dhe për të njëjtat nuk kanë vërejtje e as pyetje apo sqarime për ekspertët, të cilët kanë qenë prezent në këtë seancë. Ndërsa, gjykata të njëjtat ekspertiza i ka pranuar në tërësi si të besueshme, meqë të njëjtat ishin profesionale dhe të argumentuara, duke ofruar të dhëna të mjaftueshme lidhur me vërtetimin e fakteve vendimtare në këtë çështje kontestimore.

Në bazë të provave të prezantuara dhe gjendjes faktike të vërtetuar si me lartë, gjykata vlerëson se në këtë çështje juridike kontestuese duhet të zbatohen dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve (tani e tutje LMD).

Neni 136 paragraf 1 i LMD-së parasheh: *“Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij.”* Ndërsa, në bazë të nenit 140 të LMD-së parashihet se: *“Fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje ose nga pakujdesia.”* Kurse me paragrafin 1 të nenit 190 të LMD-së përcaktohet se: *“Për dëmin të cilin disa persona e kanë shkaktuar bashkërisht, përgjigjen të gjithë pjesëmarrësit solidarisht.”*

Me nenin 14 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, përcaktohet se: *“Në procedurën kontestimore gjykata, në pikëpamje të ekzistimit të veprës penale dhe të përgjegjësisë penale të kryerësit, është e lidhur me aktgjykimin e formës së prerë të gjykatës penale, me të cilin i pandehuri është shpallur fajtor.”*

Bazuar në gjendjen faktike si më sipër, e duke aplikuar dispozitat ligjore materiale të lartpërmendura, gjykata konstatoi se të paditurit i kanë shkaktuar dëm paditësit, përkatësisht lëndime trupore, si pasojë e sulmit fizik, i cili ka ndodhur me datë 28.05.2015. Lidhur me bazën juridike të kërkesës së paditësit, gjykata vlerësoi se Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë me numër P.nr.3105/16 i datës 18.12.2017, i plotfuqishëm nga data 31.01.2018, është provë e mjaftueshme, dhe njëkohësisht fakt vendimtar, për aprovimin e padisë së paditësit.

Në lidhshmëri me këtë, baza juridike e vendosjes në lidhje me lartësinë e kompensimit të dëmit përcaktohet me nenin 183 paragraf 1 të LMD-së, i cili përcakton se: *“Për dhembjet e pësuarat fizike, për dhembjet e pësuarat shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, të shëmtimit, të cenimit të autoritetit, të nderit, të lirive ose të të drejtave të personalitetit, të vdekjes së personit të afërm, si dhe frikës, gjykata, po të konstatojë se rrethanat e rastit sidomos intensiteti i dhembjeve dhe i frikës dhe zgjatja e tyre e arsyetojnë këtë, do të gjykojë shpërblimin e drejtë në të holla, pavarësisht nga shpërblimi i dëmit material si dhe nga mungesa e dëmit material”,* ndërsa paragrafi 2 i të njëjtit nen parasheh se: *“Me rastin e vendosjes për kërkesën për shpërblimin e dëmit jo material, si dhe për lartësinë e shpërblimit të tij, gjykata do të kujdeset për rëndësinë e cenimit të së mirës dhe të qëllimit të cilit i shërben ky shpërblim, por edhe për*

atë, se me te mos të favorizohen synimet që nuk janë në pajtim me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror". Në përputhje me të lartcekurat, e duke u bazuar në ekspertizat mjekësore, për kompensimin e dëmit, në rastin konkret gjykata ka vendosur sipas çmuarjes së lirë, duke u bazuar në nenin 323 të LPK-së, sipas të cilit "Po që se vërtetohet se palës i takon e drejta që t'i shpërblehet dëmi me të holla apo me sende të zëvendësueshme, por pa mundësi që të caktohet shuma e të hollave, apo sasia e sendeve të tilla, apo se një gjë e tillë do të mund të bëhej me vështirësi shumë të mëdha, gjykata për këtë do të vendosë sipas çmuarjes së lirë." Në raport me përgjegjësinë solidare, gjykata vendosi duke marr për bazë faktin se dëmi përkatësisht lëndimet trupore janë shkaktuar nga të dy të paditurit, për këtë arsye të njëjtit duhet të përgjigjen në mënyrë solidare, ashtu siç përcaktohet me paragrafin 1 të nenit 190 të LMD-së.

Sa i përket lartësisë së kërkesëpadisë në lidhje me dëmin jomaterial, gjykata vendosi duke marr për bazë dispozitat e lartcekura ligjore, e po ashtu edhe ekspertizën e ekspertëve mjekësor, të cilët kanë konstatuar se paditësi ka pësuar lëndime të lehta trupore. Bazuar në këto konstatime të ekspertëve, duke marr për bazë edhe natyrën e lëndimeve, gjykata vlerësoj se paditësi në emër të dhimbjeve fizike të shkaktuara si pasojë e lëndimit trupor duhet të kompensohet në lartësi prej 800.00 €. Gjukata vlerësoj lëndimet e paditësit të shkaktuara, dhe në konstatimet e lartcekura të ekspertëve lidhur me friken e përjetuar, gjykata vendosi që paditësi në emër të frikës së përjetuar si pasojë e lëndimit trupor duhet të kompensohet në lartësi prej 700.00 €.

Në raport me dëmin material, sa i përket ndihmës nga personi i tretë, eksperti ka konstatuar se e njëjta ka qenë e nevojshme në kohëzgjatje prej dy ditë, ndihmë kjo për të kryer disa nga aktivitetet e përditshme jetësore, i ndihmuar nga familjaret, siç janë veshmbathja, higjiena personale dhe përgatitja e ushqimit. Bazuar në këtë konstatim të ekspertit, gjykata e aprovoj shumën prej 20.00 euro për këtë kategori të dëmit, duke llogaritur shumën prej 10.00 euro për një ditë. Ndërsa, sipas ekspertit mjekësor, ushqimi i përforcuar ka qenë i nevojshëm për 15 ditë, ushqim i pasur me albumina, minerale dhe vitamina, i cili ndikon në rritjen e imunitetit. Bazuar në këtë konstatim të ekspertit, gjykata e aprovoj shumën prej 150.00 €, duke llogaritur shumën prej 10.00 euro për një ditë, duke vlerësuar se e njëjta është në përputhje me vlerën e cila i takon paditësit në emër të përkujdesjes nga personat e tretë. Gjukata, për këto dy kategori të dëmit material vlerëson se të njëjtat mund të njihen edhe në mungesë të provave materiale, kjo për faktin se për deri sa konstatohet se pala e dëmtuar ka pësuar dëmtime si pasojë e lëndimeve, e duke marr për bazë ekspertizat mjekësore, përkatësisht ditët për të cilat ka qenë i nevojshëm ushqimi i përforcuar dhe mbikëqyrja nga personi i tretë, atëherë mbi këtë bazë në të njëjtën kohë i njihet edhe kjo e drejtë.

Bazuar në gjendjen faktike të vërtetuar si me lartë, gjykata arriti në përfundim se të paditurit mbajnë përgjegjësi për dëmin që i është shkaktuar palës paditëse si pasojë e lëndimeve trupore, të cilin dëm të paditurit janë të obliguar të kompensojnë mbi bazën e përgjegjësisë, ashtu siç përcaktohet me nenin 136 paragraf 1, nenin 140, nenin 183 paragraf 1 dhe nenin 190 paragraf 1 të LMD-së.

Lidhur me pikën IV të dispozitivit të aktgjykimit, për pjesën e refuzuar, sa i përket dëmit jo material, gjykata vlerësoj se kompensimi përtej shumës së gjykuar nuk do të ishte në harmoni me të mirën e shkelur, duke marr për bazë natyrën e lëndimeve të paditësit dhe frikën e përjetuar,

për çka vendosi që e njëjta të refuzohet. Ndërsa, në raport me pjesën refuzuese për dëmin material, gjykata të njëjtat i refuzoj duke marr për bazë ekspertizat mjekësore të cilat kanë konstatuar ditët për të cilat ka qene e nevojshme mbikëqyrja nga personi i tretë dhe ushqimi i përforcuar.

Vendimin mbi kamatën gjykata e bazoj në nenin 382 të LMD-së, sipas të cilit: *“1. Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën. 2. Lartësia e kamatëvonesës është tetë përqind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë”*. Për dëmin jo material gjykata e njohu të drejtën në kamatë nga momenti i përpilimit të aktgjykimit me datë 07.10.2024. Kjo për faktin se pala e paditur bie në vonesë dhe është e detyruar, që përveç dëmit të paguaj edhe kamatën, nga momenti kur ka kuptuar për llojin dhe vëllimin e dëmit të shkaktuar. Ndërsa, për dëmin material, kamatën e njohu nga momenti i paraqitjes së padisë me datë 29.12.2017, duke u bazuar në propozimin e palës paditëse.

Vendimin që pala e paditur t’i bart shpenzimet e procedurës, gjykata e bazoj në dispozitat e nenit 449 dhe 452 dhe 463 të LPK-së. Ndërsa, lartësinë e shpenzimeve të procedurës gjykata e bazoj në Tarifën e Odës së Avokatëve, dhe atë për padi 104.00 euro, për tri seanca të mbajtura për secilën veç e veç nga 135.20 euro, shuma prej 405.60 euro, për ekspertiza mjekësore shumë prej 300.00 euro, si dhe për taksë gjyqësore shumë prej 40.00 euro, gjithsej shumë prej 849.60 euro në emër të shpenzimeve të procedurës gjyqësore, ndërsa kërkesën për shpenzime në emër të seancës së datës 04.06.2024, gjykata të njëjtën nuk e njohu për faktin se kjo seancë nuk është mbajtur për fajin e të paditurve.

Nga arsyet e cekura më lartë, e duke u bazuar në nenin 143 paragraf 1 të LPK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil
C.nr.3725/17, datë 07.10.2024

Gjyqtari
Argzon Muçaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi lejohet ankesa ne afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e përmes kësaj gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.